



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2583 / Prot.
22

Vlorë më, 12.11.2024

VENDIM

Nr. 63, datë 12.11.2024
PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË FINANCIARE PËR
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Në mbështetje të nenit 32, 49, pika 1, gërma ë, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 "Për percaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afateve për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Administratorit të UV-së, ardhur me shkresë 2534, prot, datë 06.11.2024, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 12.11.2024,


VENDOSI :

1. Të miratojë raportin vjetor të veprimitarisë financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin akademik 2023-2024 sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA





Blumenkoba
Lico B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 2534/Prot.

Vlorë më, 06.11.2024

Lënda: Përcjellje informacioni.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
Z. SOTIR NIKOLLA**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 24, datë 21.10.2019 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" si dhe Udhëzuesit të AKFAL nr. 75/5 prot., datë 31.07.2023 "Përcillet udhëzuesi "Për modelin e raportimit vjetor të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit" si dhe relacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse po ju paraqesim informacionin në lidhje me:

- B) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm.
- C) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.
- D) Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- E) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja.
- F) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukurore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatën Akademik të institucionit të arsimit të lartë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR

Saimir XHELAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË FINANCIARE NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË
PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË FINANCIARE

B. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.

B.1. Plan Buxheti afatmesëm për vitet 2025-2027.

Hartimi i plan-buxhetit afatmesëm 2025-2027 miratuar me Vendim Bordi nr. 34 datë 31.07.2024 është bazuar në projektet e paraqitura deri në momentin e hartimit të tij, në ecurinë e realizimit të pritsëm të buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet në: strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrit të studentëve të pritsëm dhe në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.

Nga strukturat bazë të Universitetit janë paraqitur kërkesat për projekt-buxhetin afatmesëm 2025-2027 si për procesin e veprimtarisë kryesore të këtyre njësive edhe për atë kërkimore e shkencore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë.

Financimi i P/buxhetit për vitet 2025-2027 paraqitet si më poshtë:

Tabela 21. Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 000/Lekë						
Grante nga Buxheti i Shtetit						
rtimi i projektit	Emë	Viti paraardhes 2023 (Fakti)	Viti Aktual 2024	Parashikimi Viti 2025	Viti i Pritshëm 2026	Viti Parashikim 2027
Granti për Mësimdhënien		563,559	678,528	703,455	703,455	703,455
Granti për Punën Kërkimore		2,354	2,602			
Granti për Projektet e Zhvillimit		2,122	127,879	101,795	145,000	45,982
Totali		568,035	809,009	805,251	848,455	749,437
Disbursime të projekteve të huaja						
rtimi i projektit	Emë	Viti paraardhes 2023 (Fakti)	Viti Aktual 2024	Parashikimi Viti 2025	Viti i Pritshëm 2026	Viti Parashikim 2027
Disbursime të huaja për shpenzime korente		24,003	20,966	637	6,383	2,757
Disbursime të huaja për investime		7,625	12,380	8,976		
Rimbursim nga donatori						
Totali		31,628	33,346	9,613	6,383	2,757



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

PBA për vitet 2025 - 2027				
Nr	Emërtimi i projektit	2025 000/lekë	2026 000/lekë	2027 000/lekë
1	Grante dhe transferta (Shpenzime Korente)	703,455	703,455	703,455
2	Grante dhe transferta (Shpenzime Kapitale)	101,795	145,000	45,982
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	126,443	127,536	127,852
4	Financim i huaj	9,613	6,383	2,757
Totali		941,306	982,375	880,047

1. Financimi nga buxheti i shtetit përbën 86% të buxhetit total dhe është i detajuar si më poshtë:

Tabela 21. Të dhëna për planin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 000/Lekë					
Grante nga Buxheti i Shtetit					
Emërtimi i projektit	Viti paraardhës 2023 (Fakti)	Viti Aktual 2024	Parashikimi Viti 2025	Viti i Pritshëm 2026	Viti Parashikim 2027
Granti për Mësimdhënien	563,559	678,528	703,455	703,455	703,455
Granti për Punën Kërkimore	2,354	2,602			
Granti për Projektet e Zhvillimit	2,122	127,879	101,795	145,000	45,982
Totali	568,035	809,009	805,251	848,455	749,437

2. Financimi nga të ardhurat e veta të institucionit përbën 13 % të buxhetit total i cili është i detajuar si më poshtë:

Për vitet 2025-2027 bazuar në shkresën nr. nr. 1267/14 Prot., datë 05.07.2024 të Zv. Rektorit Akademik kemi parashikuar realizimin e të ardhurave sipas tabelës së mëposhtme, limit ky i përlogaritur jo në bazë të numrit të kuotave të parashikuara, por në fakt sipas tendencës së numrit të studentëve të rregjistruar në tre vitet e fundit

Numri i studentëve në vite:

Fakulteti	Viti akademik 2017-2018	Viti akademik 2018-2019	Viti akademik 2019-2020	Viti akademik 2020-2021	Viti Akademik 2021-2022	Viti Akademik 2022-2023	Viti Akademik 2023-2024	Viti Akademik 2024-2025
Fakulteti i Ekonomisë	2,077	1,757	1,301	1,128	938	847	820	846
Fakulteti i Shkencave Teknike	1,349	1,111	1,016	898	908	1,062	1062	1,126
Fakulteti i Shkencave Humane	2,121	1,753	1,670	1,541	1,126	1,086	1066	1,064
Fakulteti i Shëndetit	1,062	1,162	954	955	954	1,034	1206	1,081
Numri i studenteve	6,609	5,783	4,941	4,522	3,926	4,029	4,154	4,117



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Tabela 21: Të ardhurat e parashikuara për 2025-2027 :

ërtimi i projektit	Em	Viti paraardhes 2023 (Fakti)	Viti Aktual 2024	Parashikimi Viti 2025	Viti i Pritshëm 2026	Viti Parashikim 2027
Qera		36	100	100	100	100
Profesionale 2-vjeçare			1,523	4,240	4,240	4,240
Bachelor		39,028	40,025	35,510	36,581	37,041
DIND			4,839	7,042	7,529	7,925
Master Profesional		24,661	22,680	28,482	28,158	28,158
Master i Shkencave		33,594	36,722	38,920	38,419	38,419
Doktoraturë		200	2,000	2,000	2,000	2,000
Trajnimi mësuesve		445	600	600	600	600
Libreza Diploma etj.		4,788	2,176	2,414	2,414	1,414
Lëshim dokumenti		3,432	2,325	2,940	2,940	2,400
Taksë regjstrimi		3,024	3,993	3,695	4,055	4,055
Tarifa konkurrimi						
Tjera - shërbime		0	0			
Pjesm. konferenca						
Sponsorizime		7,143	5,000	500	500	500
Totali		116,351	121,983	126,443	127,536	126,852

Në realizimin e të ardhurave negativisht ndikojnë faktorët si:

- Numri i rasteve të përjashtim/reduktim nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM-ve dhe Vendimeve të BA-së për përjashtim/reduktim nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve perfitojnë reduktim/përjashtim nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të Ciklit të parë të studimeve dhe reduktim 50% të tarifës së shkollimit per ciklin e dytë te studimeve (Master). - Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.

- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi.

Tabela 21: Efektet financiare nga VKM-të:

Emërimi	Tabela 21. Efektet financiare nga VKM-të /000 Leke									
	Viti Paraardhës 2023		Viti aktual 2024		Viti Pasardhës 2025		Viti 2026		Viti 2027	
	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera	Nr. Studentë	Vlera
VKM nr. 903, datë 21.12.2016 (Bursa)	314	25,447	269	20,050	251	22,000	251	22,000	251	22,000
VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (Reduktim bachelor)	1,492	14,920	1,598	17,249	1,330	13,300	1,330	13,300	1,330	13,300
VKM nr. 269, datë 29.03.2017 (Përjashtim Bachelor)	336	5,263	342	4,846	342	4,756	342	4,756	342	4,756
VKM nr. 386, datë 01.06.2022 (Bursa programe prioritare)	7	3,060	16	5,760	16	5,760	16	5,760	16	5,760
VKM nr. 780 datë 26.12.2018 (Reduktim Master)	86	2,740	71	3,974	55	1,498	55	1,498	55	1,498
Totali	2,235	51,430	2,296	51,879	1,994	45,816	1,994	45,816	1,994	45,816



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Shpenzimet nga të ardhurat janë parashikuar të realizohen 13% për paga dhe sigurime, 66% për shpenzime operative, 16% për Kërkimin Shkencor dhe 5 % për investime, përkatesisht si me poshtë:

2. Të ardhura të institucionit për vitin 2025 - 2027				
Nr	Emërtimi i projektit	2025	2026	2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Fondet nga të ardhurat për paga	19,200	19,200	19,200
2	Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente	61,499	62,336	62,152
3	Fonde nga të ardhurat për projekte e k. shkencor	41,044	40,500	41,000
4	Fonde nga të ardhurat për investime	4,700	5,500	5,500
4	Totali	126,443	127,536	127,852

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit të Universitetit përbën PBA-në e viteve 2025-2027.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra si: energji, ujë, telefon, në shërbimet që dalin të detyruara si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime qera etj.

Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga realizimi i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

Artikulli	Emertimi	000/Lekë				
		Fakti 2023	I pritshmi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
1	2			7	8	9
	<<Emertimi i Programit>>					
602	Materiale zyre dhe te pergjithshme	4,250	9,262	8,890	9,090	8,890
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	6,667	19,794	9,941	10,941	10,941
602.2	Sherbime nga te trete	17,301	30,035	29,408	29,208	29,208
602.3	Shpenzime transporti	1,432	1,730	1,730	1,730	1,730
602.4	Shpenzime udhetimi	3,256	3,500	2,000	2,000	2,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,451	4,597	3,500	3,400	3,400
602.6	Shpenzime per qeramanje	11,292	11,287	11,036	11,036	11,036
602.7	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	1,832	0	0	0	0
602.9	Shpenzime te tjera operative	9,463	19,342	14,394	14,331	14,347
	Totali	56,944	99,547	80,899	81,736	81,552



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Financimi nga projektet e huaja mbulon rreth 2% te buxhetit total të UV-së.

Tabela 21

Disbursime të projekteve të huaja					
Emërtimi i projektit	Viti paraardhës 2022 (Fakti)	Viti Aktual 2023	Parashikimi Viti 2024	Viti i Pritshëm 2025	Viti Parashikim 2026
Disbursime të huaja për shpenzime korente	23,812	13,686	4,738	15,828	13,027
Disbursime të huaja për investime	14,929	11,340	5,500		
Rimbursim nga donatori		4,000			
Totali	38,741	29,026	10,238	15,828	13,027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

B.2. Plani buxhetor njëvjeçar viti 2025.

P/Buxhetin për vitin 2025 po e paraqesim në mënyrë analitike si më poshtë:

B.2.1. Të ardhura - hyrjet e fondeve.

B.2.2. Shpenzimet.

B.2.1. Të ardhurat - hyrjet e fondeve.

Hyrjet e fondeve në institucione përbëhen nga : Granti i buxhetit të shtetit, të ardhurat e veta të UV-së dhe të ardhurat nga financimi i huaj.

Bazuar në shkresat e MAS nr. 484 prot., datë 26.02.2024 "Dërgohen fondet e miratuara të shpenzimeve kapitale për vitet 2024-2026", bazuar në kërkesat e institucionit si dhe parashikimit të realizimit të të ardhurave të veta bazuar në shkresën nr. 1267/14 Prot., datë 05.07.2024 të Zv. Rektorit Akademik buxheti total i UV-së parashikohet si më poshtë :

Tabela 22.a		Plani buxhetor njëvjeçar i të ardhurave 000/leke		
Nr	Emërtimi i Projektit	Mbartur nga viti paraardhës	Financimi i vitit aktual	Buxheti vitit
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	0	805,250	805,250
1.1	Granti mësimdhënies		681,455	681,455
1.2	Granti i bursave të studentëve cikli parë		22,000	22,000
1.3	Granti Konkurrues		100,000	100,000
1.4	Granti Kërkimit shkencor			0
1.5	TVSH- Projekte të huaja		1,795	1,795
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	0	9,613	9,613
2.1	Disbursime të huaja për shpenzime korente		637	637
2.2	Disbursime të huaja për investime		8,976	8,976
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	0	126,443	126,443
3.1	Të ardhura për shpenzime korente		80,699	80,699
3.2	Të ardhura për investime		4,700	4,700
3.3	Të ardhura për kërkim shkencor		41,044	41,044
	Totali	0	941,306	941,306



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

1. Granti i buxhetit të shtetit është në shpenzime për paga dhe sigurime, shpenzime për investime dhe shpenzimet për bursa:

Grante për vitin 2025		
Nr	Emërtimi i projektit	000/lekë
1	Grante për shpenzime korente (paga+shp.operative)	681,455
2	Grante për investime	101,795
3	Granti për Bursa	22,000
Totali		805,251

Financimi i pritshëm nga Granti për vitin 2025 parashikohen në vlerën 805,251,000 lekë, i detajuar si më poshtë:

Grante për shpenzime korente dhe Transfera 703,455,338 lekë të cilët ndahen:

- o Granti dhe bursat e studentëve është me vlerë 22,000,000 lekë.
- o Granti për paga është me vlerë 583,554,010 lekë.
- o Granti për sigurime shoqërore shëndetësore është me vlerë 77,901,329 lekë.
- o Granti për shpenzime operative është me vlerë 20,000,000 lekë.

Grant konkurrues – fondet për investime:

- o Granti për investime është me vlerë 100,000,000 lekë për ndertimin e godinës së FSH
- o TVSH për projektet e huja në vlerën 1,795,200 lekë.

Të ardhura të institucionit.

Të ardhura të institucionit për vitin 2025		
Nr	Emërtimi i projektit	2025
		000/lekë
1	Fondet nga të ardhurat për paga	19,200
2	Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente	61,499
3	Fonde nga të ardhurat për projekte e k. shkencor	41,044
4	Fonde nga të ardhurat për investime	4,700
TOTALI		126,443
1	Projektet me Financim te Huaj	9,613

Fonde të kushtëzuar – të ardhurat e institucionit për vitin 2025 parashikohen 126,443,000 lekë.

- Tarifa e shkollimit Cikli Bachelor me vlerë 46,792 lekë ose 38 % e të ardhurave vjetore.
- Tarifa e shkollimit Master Profesional me vlerë 28,482 lekë ose 23 % e të ardhurave vjetore.
- Tarifa e shkollimit Master Shkencor me vlerë 38,920 lekë ose 31 % e të ardhurave vjetore.
- Tarifa e regjistrimit me vlerë 3,695 lekë ose 3 % e të ardhurave vjetore.
- Të ardhura nga librezja, diploma,vertetime etj me vlerë 6,554 lekë ose 5 % e të ardhurave vjetore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Të ardhurat e parashikuara për vitin 2025 do të përdoren sipas tabelës së mëposhtme.

TE ARDHURAT E INSTITUCIONIT PER VITIN 2025						
KRIJIMI			SHPERNDARJA			
Nr.	Emërtimi	000/Lekë		Emërtimi		000/Lekë
1	Qeratë	100		Totali		126,443
2	Bach. koha plotë	46,792		Studim projekte	230	0
3	M. Profesional	28,482		Investime 231	231	4,700
4	M. Shkencor	38,920		Investime 231 K.SH		1,500
5	Doktoraturë	2,000		K. shkencor - 602	602	39,544
6	Libreza Diploma etj.	2,414	A. Përdorimi	Paga e shpërblime	600+601	19,200
7	Lëshim dokumenti	2,940		Shpenzime operative	602	60,899
8	Taksë regjstrimi	3,695		Transf. jashtë	605	600
9	Të tjera	600		Transf. tek individë	606	0
10	Sponsorizime	500				
				B. Pa përdorur		
	Totali	126,443		C. Trashëgohen		

Realizimi i të ardhurave është llogaritur duke u bazuar në të dhënat e parashikuara për numrin e studentëve që do të vazhdojnë studimet në vitin akademik 2023-2024, për studentët në vazhdim, parashikimin e regjistrimeve për vitin e parë. Për llogaritjet janë bazuar në Vendimet e Bordit të Administrimit për tarifën e shkollimit në Bachelor, MP, MSH, tarifën për kredit në ciklin e dytë master dhe tarifën e regjistrimit për vitin akademik 2023-2024.

Numri i studentëve i parashikuar për vitin 2025 dhe parashikimi i të ardhurave:

Cikli I studimit	F.Ekonomisë	F.Shkencave Humane dhe Drejtësisë	F.Shëndetit	F.Shkencave Teknike dhe Natyrore	Total Uv
Bachelor	588	368	1,027	969	2,952
M.Profesional	107	180	92	98	477
M.Shkencor	221	281	43	74	619
Prog.Integ.Drejtesi PIND	0	271	0		271
Doktoraturë		10		0	10
Total	916	1,110	1,162	1,141	4,329

Të ardhurat e veta të institucionit janë llogaritur bazuar në evidencave zyrtare statistikore të regjistrimit të studentëve në tre vitet e fundit, referuar shkresës nr. 1267/14 Prot., datë 05.07.2024 të Zv.Rektorit Akademik, Vendimeve të Bordit të Administrimit nr. 20 date 15.05.2024 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në të gjitha programet e studimeve për vitin akademik 2024-2025".

Me qëllim planifikimin e saktë të fondeve për financime të shpenzimeve për vitet 2025-2027 nga të ardhurat dytësore është analizuar situatën konkrete të ardhurave, tendencën e të ardhurave në tre vitet e fundit si dhe ecurinë e regjistrimit të studentëve.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË ADMINISTRATOR


Në vitin 2025 parashikohet realizimi i të ardhurave në vlerën 126,443,000 lekë.

Nga zbatimi i akteve ligjore për shtresat të ndryshme sociale dhe për studentët ekselentë në Universitetet përfitojnë përjashtim/reduktim tarife afërsisht 397 studentë në çdo vit akademik me një efekt rreth 6,253,200 lekë, gjë e cila ndikon në një realizim më të ulët të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2025.



Përdorimi i të ardhurave, viti 2025.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

B.2.2. Shpenzimet

Fondet e hyra në Universitet nga Granti, transfertat, të ardhurat që krijon vetë institucioni dhe projektet e huaja, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore përbëjnë P/Buxhetin e shpenzimeve të vitit 2025.

Tabela 22.b Plani buxhetor njëvjeçar i shpenzimeve (2025)					000/Lekë
Nr	Emërtimi shpenzimit	Grant	P/huaja	Të ardhura	Total Buxheti
	Paga e shperblime	583,554	0	15,700	599,254
-	Pagat	583,554		15,700	599,254
-	Honorare - oret				0
2	Sig. Shogërore	77,901		3,500	81,401
3	Shpenzime operative	20,000		60,899	80,899
4	Transf. me jashtë			600	600
5	Transf. individet			0	0
6	Bursa	22,000			22,000
7	Kërkimi shkencor	1,795	0	41,044	42,839
-	Kërkimi shkencor	1,795		41,044	42,839
8	Investime				0
a	Studim projektme, soffte	0	0	0	0
-	Studime e projektme				0
-	Patenta, soffte kompjuterike				0
b	Investime trupëz.	100,000	0	4,700	104,700
-	Ndërtime të reja	100,000		200	100,200
-	Rikonstruksione				0
-	Instalime rrjete				0
-	Makineri teknologjike				0
-	Paisje profesionale	0		2,500	2,500
-	Paisje inventar ekonomik			2,000	2,000
-	Mjete transporti				0
9	Projekte të huaja	0	9,613	0	9,613
-	Shpenzime korente		637		637
-	Shpenzime Investime		8,976		8,976
-	Ridisbursim i projekt huaj				0
	<i>Totali</i>	805,250	9,613	126,443	941,306

➤ Për artikullin paga e shpërblime – Art. 600.

Bazuar në informacionin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë parashikon për vitin 2025-2027 fondin e pagave për 354 personel me kohë të plotë akademik dhe joakademik (ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ) nga të cilët 67 % personel akademik dhe 33% personel ndihmësakademik, si dhe 125 staf të ftuar dhe me kohë të pjesshme. Shpenzimet për paga janë parashikuar në vlerën 599,254 mijë lekë dhe për sigurime në vlerën 81,401 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

	Nr. Staf	Fond Page /000 Lekë
Shpenzime për fond page UV		
Staf akademik me kohë të plotë	240	460,583
Staf ndihmës/akademik me karakter administrativ	114	146,368
mësimor dhe personel administrativ	5,512	7,000
Shkrim Hartim Projektsh (ore)	52,105	50,688
Orë suplementare	3,000	8,115
Staf Akademik I ftuar (ore)	9,600	7,901
Staf Akademik me kohë të pjesshme (ore)		680,655
Totali		

- Për stafin akademik dhe personelin mbështetës planifikohet fondi i pagave dhe sigurimeve në vlerën 680,655 mijë lekë, në mbështetje të Vendimit nr. 243, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendim nr.234, datë 20.04.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, të ndryshuar, Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" VKM nr. 325, date 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të njeleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 326, date 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike",
- Vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" të ndryshuar. Udhëzimit nr. 29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", është bërë planifikimi për zërin shpenzime paga duke patur parasysh faktet si më poshtë :
- Strukturën organike sipas Vendimin e Senatit Akademik nr. 12 datë 27.02.2019 dhe vendimit të Bordit të Administrimit nr. 17 datë 03.04.2019.
 - Numrin e pedagogëve sipas të titujve që mbajnë aktualisht, si dhe kualifikimet e mundshme të tyre me studime pasuniversitare për kalimin e shkallëve të kualifikimit, funksione drejtuese në administratë, etj.
 - Orët suplementare të parashikuara për stafin me kohë të plotë.
 - Numri dhe ngarkesa e stafit të ftuar dhe me kohë të pjesshme.
- Si dhe në zbatim të vendimit të vendimit të BA-së nr. 7 datë 23.02.2023 "Për miratimin e rritjes së pages për stafin akademik të UV-së" është llogaritur dhe rritja 5% nga të ardhurat e UV-së.
- Fondi i pagave nga Granti i mësimdhënies në vlerën 583,554,010 lekë.
 - Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit në vlerën 77,901,329 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR**

Në fondin e pagave përfshihet edhe pagesa për orët suplementare që do të zhvillohen nga personeli akademikë efektivë sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", dhe pagesa e pedagogëve të jashtëm.

Shpenzime për fond page UV	Orë	Fond Page /000 Lekë
Orë suplementare	52,105	50,688
Staf Akademik I ftuar (ore)	3,000	8,115
Staf Akademik me kohë të pjesshme (ore)	9,600	7,901
Totali	64,705	66,704

➤ **Për artikullin fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore Art. 601**

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore e shëndetësore prej 81,401,329 lekë mbulon pagesat deri në fund të vitit.

➤ **Për artikullin shpenzime operative Art. 602**

Në planifikimin e shpenzimeve operative janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm, të cilat do të mundësojnë shpenzimet në rritje në disa zëra si: energji, ujë, telefon, në shërbimet që dalin të detyruara si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin, shpenzime për mirëmbajtje, shpenzime qira etj.

Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga realizimi i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

Shpenzimet operative për vitin 2025:

Artikulli	Emertimi	000/Lekë		
		Fakti 2023	I pritshmi 2024	Parashikimi 2025
1	2			7
	<<Emertimi i Programit>>			
602	Materiale zyre dhe te pergjithshme	4,250	9,262	8,890
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	6,667	19,794	9,941
602.2	Sherbime nga te trete	17,301	30,035	29,408
602.3	Shpenzime transporti	1,432	1,730	1,730
602.4	Shpenzime udhetimi	3,256	3,500	2,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,451	4,597	3,500
602.6	Shpenzime per qeramarrje	11,292	11,287	11,036
602.7	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	1,832	0	0
602.9	Shpenzime te tjera operative	9,463	19,342	14,394
	Totali	56,944	99,547	80,899



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR**

Këto shpenzime do të mbulohen 75 % nga të ardhurat dytësore dhe 25 % nga buxheti i shtetit, për të cilat është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik.

➤ **Për artikullin transferta të jashtme Art. 605**

Ky artikull është planifikuar për përballimin e shpenzimeve të anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare, si për universitetin ashtu dhe për fakultetet. Parashikimi i këtij zëri është kryer në mënyrë të përafërt nga eksperiencia e viteve të mëparshme.

1. Antarësimin vjetor të EUCEN me vlerë	60,000 lekë
2. Antarësimin vjetor të ASECU me vlerë	60,000 lekë
3. Antarësimin vjetor të MAGNA KARTA me vlerë	80,000 lekë
4. Antarësimin vjetor të ETEN me vlerë	50,000 lekë
5. Antarësime të reja	350,000 lekë

➤ **Për artikullin bursat e studentëve dhe transferta tek individët Art. 606.**

Shpenzimet për bursa mbulohen 100% nga buxheti i shtetit. Granti i akorduar për Bursa për UV-në për përballimin e efekteve financiare që kanë ardhur nga zbatimi akteve ligjore për kategoritë e studentëve që përfitojnë bursë financiare është 22,000 mijë lekë.

Artikulli 606 kapitulli 8 përfshin të gjitha ato shpenzime për të cilat institucioni nuk përfiton mallra ose shërbime. Shpërndarja e buxhetit në këtë artikull pasqyron kërkesat e institucionit tonë për bursat e studentëve të cilat planifikohen në zbatim të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" i ndryshuar me Vendimin nr. 784, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave, si dhe me Vendimin nr. 39 datë 23.1.2019 të KM, bazuar dhe në numrin faktik të bursistëve sipas vendimeve të Bordit të Administrimit për vitin akademik 2023-2024 dhe realizimit të vitit 2023.

UV	Studente ekselente		Studente ne nevojë	
	Nr. Studente	Efekt.Financiar	Nr. Studente	Efekt.Financiar
FE	23	1,955,000	18	1,530,000
FSHH	19	1,615,000	40	3,410,000
FSH	23	1,955,000	99	8,415,000
FSHTN	25	2,125,000	4	350,000
TOTAL	90	7,650,000	161	13,705,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

➤ Për artikullin investime Art. 230/231

Në projekt- buxhetin e vitit 2025-2027 prioritet i është kushtuar investimeve për krijimin e infrastrukturës sa më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, aktiviteteteve akademike, mbështetjes studentore, promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

Nisur nga niveli i të ardhurave të parashikuara, duke marrë në konsideratë të mbulohen gjithë shpenzimet e pagave, kërkimit shkencor dhe shpenzimet për mbarëvajtje normale të punës, kondicionuar nga këto kushte për investime për vitin 2025 janë parashikuar 107,995 mijë lekë investime nga të cilat 101,795 mijë lekë janë nga buxheti shtetit dhe 6,200 mijë lekë janë nga të ardhurat e institucionit.

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2025 është bërë mbi bazën e nevojave të evidentuara në institucion.

4	5	6	7	8	9	10	11		12
							Buxheti 2024		
Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit të investimit	Vlera e plotë e projektit	Plani	Realizuar	
01	9450	2312103	3737	18BD512	NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	290,982	0	0	100,000
06	9450	2312103	3737	91105AA	NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE	124,706	12,470		
06	9450	2302100	3737	91105AA	KOLAUDIM NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE				
06	9450	2302100	3737	91105AA	MBIKQYRJA NDERTIMI I OBJEKTIT TË RI TË FSH-SE				
06	9454	2312103	3737	91105AA	Studim Projektim sistem Ngrohje Frohje				200
06	9454	2314170	3737	91105AA	Blerje Pajisje Laboratorike				2,500
06	9454	2312103	3737	91105AA	Rikonceptim I hollëve në Fakultete				0
06	9454	2318600	3737	91105AA	Blerje pajisje elektronike				2,000
					Totali				104,700

Gjithashtu sipas shkresës së MAS nr. 370 prot., datë 16.01.2024 "Për parashikimin e fondeve të projekteve me financim të huaj për periudhën 2025-2027", me vendim të BA-së nr. 5 datë 25.01.2024 Universiteti ka planifikuar të bashkëfinancojë projektet në kuadër të ndërkombëtarizimit si më poshtë:

Entiteti i Qeverisjes	Grupi	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i projektit	Emertimi i projektit të investimit	Vlera e plotë e projektit	Programi 09770 /1000 Loke				
									Buxheti 2024		Kërkesa 2025	Kërkesa 2026	Kërkesa 2027
									Plani	Realizuar			
001		06	9770	2314140	3737	91105AA	Bashkëfinancim për projektet e MAS	8,304	6,804	1,500	1500	1500	
001		08	9770	2314140	3737	91105AA	T'shi për projektet e Huaja	2,187	0	1,795	0	0	
							Totali	12,099	6,804	3,295	1,500	1,500	

1. Përqindjen më të lartë të kuotës së planifikuar në këtë zë e ka "Ndërtimi i godinës së re të Fakultetit të Shëndetit" për të cilin është lidhur kontrata nr. 15/24 prot., datë 11.06.2021 me vlerë totale 415,689 mijë lekë.

Ngritja e godinës për Fakultetin e Shëndetit parashikoht për vitet 2025-2027 dhe mënyra e financimit është 70% nga buxheti i shtetit, sipas shkresës së MAS nr. 2091/4 prot., datë 02.06.2021, dhe 30% nga të ardhurat e Universitetit "Ismael Qemali" Vlore.

Për vitin 2025-2027 shpenzimet për ngritjen e Godinës për Fakultetin e Shëndetit janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR

Financim	Emërtimi projektit	Fondi /000 lekë	2024	2025	2026	2027
		Total				
Buxheti	Ndërtim i godinës Fakultetit te shendetit"	290,982	0	100,000	145,000	45,982
Të ardhura	"Ndërtim i godinës Fakultetit te shendetit"	124,706	124,706	0		
	TOTALI	415,689	124,706	100,000	145,000	45,982

Për vitet 2025-2027 bazuar në nivelin e të ardhuarve të parashikuara ecurisë së buxheteve në vite si dhe kërkesave të përditësuara të fakulteteve dhe rekomandimeve të akreditimit institucional prioritet do të kenë investimet të cilat do të fokusohen në përmirësimin i infrastrukturës së ambienteve të auditoreve dhe sallave me mjete të logjistikës për mirëfunksionimin e mësimdhënies.

Prioritetet kryesore do të jenë:

Përmirësimi i auditoreve të leksioneve

Me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies kemi parashikuar blerjen e krahëve për montimin e video projektorëve ekzistues në sallat e leksioneve.

Për shpenzimin "Studim projektim i sistemit të Kaldajës" Bazuar në rekomandimeve të akreditimit si dhe bazuar në përgjigjet e pyetësoreve të studentëve prioritet do të kenë paisja e auditoreve me system ngrohje – ftohje. Duke qënë se në Godinën B dhe C janë të instaluar sistemi i kaldajave por me problematika të shumta në rrjetin e shpërndarjes, mendojmë të planifikojmë një fond për vitin 2025 për një studim të hollësishëm ku të bëhet dhe preventive për vënien në punë të këtyre kaldajave.

Blerje e pajisjeve elektronike Fotokopje Printer. Pasi u panë gjithë kërkesat e njëjësive për "Blerje pajisje elektronike" dhe evidentimin e gjendjes fizike të pajisjeve elektronike në fakultete, për të siguruar ecurinë normale të punës, bazuar dhe në volumin e punës janë parashikuar të blihen pajisje elektronike për të pajisur fakultetet me logjistikën e nevojshme për këtë qëllim.

Paisje Labororike.

Bazuar në kërkesën e Fakultetit të Shëndetit dhe Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore në mbështetje të procesit mësimor, të zhvillimit të praktikave mësimore është vlerësuar blerja e paisjeve labororike të cilat do të pasurojnë labororet ekzistuese.

Për vitet 2026-2027 bazuar në nivelin e të ardhuarve të parashikuara ecurisë së buxheteve në vite si dhe kërkesave të përditësuara të fakulteteve dhe rekomandimeve të akreditimit institucional prioritet do të kenë investimet të cilat do të fokusohen në përmirësimin i infrastrukturës së ambienteve të auditoreve dhe sallave me mjete të logjistikës për mirëfunksionimin e mësimdhënies. Bazuar në kërkesat e Fakulteteve në mbështetje të procesit mësimor, të zhvillimit të praktikave mësimore është vlerësuar blerja e paisjeve labororike të cilat do të pasurojnë labororet ekzistuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

➤ **Projektet e Huaja**

- Bazuar në marrëveshjet e projekteve me financim të huaj si dhe në udhëzimin nr. 35 datë 21.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjes ndërkombëtare" i ndryshuar ; ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" Tvsh për projektet e huaja është parashikuar në vlerën 3,740 lekë.

Nr	Kodi Projektit	Emri i Projektit	Emër Mbiemër i Koordinatorit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë	Viti fillimit	Viti Mbarimit	Vlera Totale e Projektit (Grant) EUR	Vlera e Transhit që pritet të	Kerkesa për bashkefinancim nga	Vlera e pajisjeve që do të blihen për vitin 2025 sipas	Tvsh (Eur)	Vlera e Transhit që pritet të
1	20AB225	UV_Projekti INTEC	Prof. Asoc. Enkelejd Mehili	2023	2026	78,624	35,381	25,800	38,000	7,600	21,229
2	20AB226	UV_Projekti CRED4TEACH	Dr. Eva Cipi	2023	2026	42,777	8,555	2,852			2,851
3	20AB252	UV_ SMART	Prof. Asoc. Fioralba Vela	2022	2025	73,536	9,524				0
4	20AB271	UV_ILOFORDIGITAL	Fioralba Vela	2024	2025	34,348	19,665				13,108
5	20AB272	UV_ MORIN	Prof. Asoc. Armela Panajoti	2023	2025	70,399	21,120	3,000			0
6	20AB273	UV_ HAWKING	Prof. Asoc. Bledar Toska	2023	2026	61,764	0	2,500			25,393
7	20AB274	UV_ WB HEI ZERO	Prof. Asoc. Kristofor Lapa	2023	2025	135,156	0	9,460	50,000	10,000	0
7		Total				496,604	94,245	43,612	88,000	17,600	62,581

C. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifave të shkollimit për vitin akademik në vijim. (Bashkelidhur tabela 23)

C.1. Realizimi i buxhetit vitit 2023.

Për vitin 2023 buxheti i miratuar me Vendim Bordin nr Administrimit nr. 3 datë 23.02.2023 është parashikuar në vlerën 848,656,707 lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe nga të ardhurat e vet institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

BUXHETI vitit 2023								
Nr	Emërtimi i programit	Fonde të hyra			Shpenzime			
		Buxheti vjetor	Akorduar	në %	Emërtimi i programit	Çelur për përdorim	fakt	në %
1	Grant konkurrenues	5,879,000	5,879,000	0	Grant konkurrenues	5,879,000	5,879,000	100%
2	Grant kërkimi shkencor Investime 231	1,543,461	1,543,461	100%	Grant kërkimi shkencor Investime 231	1,543,461	1,543,461	100%
3	Grant kërkimi shkencor 602	8,017,085	8,017,085		Grant kërkimi shkencor 602	8,017,085	4,481,832	56%
I	Buxheti i brendshëm	15,439,546	15,439,546		Buxheti i brendshëm	15,439,546	11,904,293	77%
1	Grant mësimdhënie	623,438,546	623,438,546	100	Grant mësimdhënie	623,438,546	563,561,440	90%
2	Granti për Ndertime	82,757	82,757	100	Granti për Ndertime	82,757	0	0%
II	Grant	623,521,303	623,521,303	100	Grant	623,521,303	563,561,440	90%
1	Të ardhurat e trashëguara vitit 2022	137,503,448	137,503,448	100%	Të ardhura të vetë UV	160,503,448	81,848,177	51%
2	Të ardhura 2023	116,353,188	116,353,188	100%				
III	Të ardhura	253,856,636	253,856,636	100%	Të ardhura	253,856,636	81,848,177	32%
1	Projekti të huaja	31,627,565	31,627,565	100%	Projekti të huaja	44,170,184	34,051,330.00	77%
IV	Projekti të huaja	31,627,565	31,627,565	100%	Projekti të huaja	44,170,184	34,051,330.00	77%
	Totali	924,445,050	924,445,050		Totali	936,987,669	691,365,240	74%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ADMINISTRATOR**

Granti konkurrues **5,879,000** lekë.

-Projekte të huaja **31,627,565** lekë.

-Grant mësimdhënie **623,438,546** lekë.

-Granti për ndërtime **82757,000** lekë.

-Të ardhura të institucionit (të vitit 2023 dhe të trashëguara nga një vit më parë) **253,856,636** lekë, nga të cilat janë celur për përdorim 160,503,448 lekë.

Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat:

"Buxheti viti 2023 "të ardhurat për vitin 2023 - fakti", "realizimi i buxhetit për vitin 2023-fakti". (Pasqyrohen të ardhurat dhe fondet e celura për shpenzime në degën e thesarit).

C.1.1. Hyrjet e fondeve

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2023 të ndara sipas financimeve kanë qenë:

Granti konkurrues:

- Granti konkurrues për financimin e investimeve, projektet e Ndërkombëtarizimit – 5,879,000 lekë , i cili është realizuar 100%
- TVSH për projekte në vlerën 1,543,461 lekë, i cili është realizuar 100%.
- Për financimin e ndërtesës së FSH-së, ishte parashikuar nga buxheti i shtetit 122,000,000 lekë, nga MFE u financua vlera 82,757 lekë.

Grant mësimdhënie: Në vlerën 623,438,546 lekë, i cili është realizuar 90%.

- Për kërkimin shkencor, financimi prej 8,017,085 lekë ,eshte realizuar në masën 56%.

Projektet e huaja: Hyrjet e fondeve nga Projektet me Financim të Huaj për vitin 2023 ishin 31,627,565 lekë. Nga viti 2022 gjendja në bankat e nivelit të dytë për projektet ishte 12,542,619 lekë. Projektet e huaja janë realizuar në masën 77% të financimit .

Fonde të kushtëzuar – të ardhurat e UV-së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar 97% në vlerën 253,856,636 lekë. Këto të ardhura janë realizuar gjatë vitit deri në 31 Dhjetor 2023 në vlerën 116,353,188 lekë me realizim plani vjetor 95 %, ndërsa janë trashëguar nga viti 2022 të ardhura të papërdorura në vlerën 137,503,448 lekë.

Të ardhurat për vitin 2023– fakti.

Nr	Emërtimi	Të ardhurat viti 2023		
		Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	123,003,246	116,353,188	95%
1	Qera	200,000	36,120	144%
2	Bachelor e programe profesionale	41,474,646	39,028,600	94%
3	M. Profesional	26,892,000	24,661,009	92%
4	M. Shkencor	35,976,600	33,594,000	93%
5	Doktoraturë	1,000,000	200000	20%
6	Libreza Diploma etj.	4,448,000	4,788,457	108%
7	Lëshim dokumenti	5,064,000	3,877,545	77%
8	Taksë regjstrimi	3,948,000	3,024,000	77%
12	Sponsorizime	4,000,000	7,143,457	179%
B	Të ardhura të trashguara	137,503,448	137,503,448	100
1	Trashguar nga 2022	137,503,448	137,503,448	100
	Totali	260,506,694	253,856,636	97%




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË ADMINISTRATOR

Plani i realizimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2023 u bazua në:

- Programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- Programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- Numrin e studentëve për çdo program studimi,
- Nivelin e tarifave të vendosura me vendim BA për çdo program studimi.



Në zërat e të ardhurave të realizuara peshën kryesore e zënë:

-Tarifat e shkollimit rreth 84 % ndaj totalit ose 93 % ndaj parashikimit, realizimi i të cilave është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë të Studimit.

Këto të ardhura përbëhen nga:

- Tarifa e shkollimit në Bachelor 34 % ndaj totalit ose 94 % ndaj parashikimit.
- Tarifa e shkollimit në Ciklin e dytë të studimeve, nga e cila Master profesional rreth 21 % ndaj totalit ose 92 % ndaj parashikimit, ndërsa Master i shkencave 29 % ndaj totalit ose 93 % ndaj parashikimit.
- Peshën tjetër e zë tarifë regjistrimi, vertetime etj.

Në realizimin e të ardhurave negativisht kanë ndikuar edhe efekte si më poshtë:

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit, në zbatim të VKM-së dhe Vendimeve të BA-së për përjashtim/reduktim nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit të studentëve të Ciklit të parë të studimeve dhe reduktim 50% të tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve (Master). Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim efekti financiar për përjashtim/reduktim është 6,924,400 lekë sipas tabelës së mëposhtme:
- Moshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

